

VENDIM
Nr. 126, datë 28.10.2013

MBI SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRIVE “HEC ULËZ-SHKOPET” SHA DHE “HEC BISTRICA 1, BISTRICA 2” SHA, PËR TRANSFERIMIN E LICENCAVE TË PRODHIMIT, TREGTIMIT DHE FURNIZUESIT TË KUALIFIKUAR TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA KËTO SHOQËRI TE SHOQËRIA “KURUM INTERNATIONAL” SHA

Në mbështetje të nenit 9 dhe 20 pika 1 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 17 pikat 1, 4 gjerat “a”, “b”, “c”, 5 dhe 7 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, pikës 1.3 të licencës së aktivitetit të tregtimit dhe të furnizuesit të kualifikuar, Bordi i Komisionerëve i ERE-s në mbledhjen e datës 28.10.2013, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

konstatoi se:

1. ERE, në bazë të nenit 4 pika 3 të “Rregullores së transferimit të aseteve”, në të cilin citohet se: “Për transferimin e aseteve që realizohet në kuadër të procesit të privatizimeve në sektorin publik, nuk do të aplikohet kjo rregullore”, në kompetencë të saj ka vetëm trajtimin e transferimit të licencave të subjekteve “Hec Ulëz-Shkopet” sh.a. dhe “Hec Bistrica 1, Bistrica 2” sh.a.

2. Dokumentacioni i paraqitur nga subjektet “Hec Ulëz-Shkopet” sh.a. dhe “Hec Bistrica 1, Bistrica 2” sh.a., në lidhje me transferimin e licencave, është konform kërkesave të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Neni 17, pika 1, pika 4, gjerat “a”, “b”, “c”

Është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë transferimin e licencave të prodhimit, tregtimit dhe furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike nga shoqëritë “Hec Ulëz-Shkopet” sh.a. dhe “Hec Bistrica 1, Bistrica 2” sh.a., të shoqëria “Kurum International” sh.a.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e shoqërisë “Kurum International” sh.a. për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Petrit Ahmeti